



V E N D I M

Nr.447, Datë 22.7.2021

PËR

KRITERET E DHËNIES SË BURSAVE PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE, PËR TË STUDIAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, NGA AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ë” të nenit 5, të Ligjit nr. 16/2018 “Për diasporën”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e 9 (nëntë) bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2021-2022.
2. Bursa e studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare përfshin mbulimin financiar për tarifën e studimeve, si dhe shpenzimet e akomodimit e të ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik, në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Për vitin akademik 2021-2022 do të akordohen 9 (nëntë) bursa për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë për vendet si më poshtë vijon:
 - a) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina;
 - b) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit Arbëresh në Itali;
 - c) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci;
 - ç) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgari;
 - d. 1 (një) bursë studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Turqia.
4. Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë të akredituara në vendet e përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, bëjnë propozimet për kandidatët për përfitimin e bursës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për vitin akademik 2021-2022. Ato janë përgjegjëse për dërgimin e dokumentacionit të kërkuar për kandidatët përfitues të bursës.
5. Dokumentacioni që do të paraqitet nga aplikantët duhet të jetë i legalizuar në përputhje me legjislacionin që rregullon njohjen dhe përdorimin e dokumenteve zyrtare të lëshuara jashtë vendit.



6. Kriteret bazë për përfitimin e bursës që duhet të plotësoj aplikanti janë si më poshtë vijon:

- a) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm me një mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë) ose të barasvlershme me të;
- b) Të mos jetë i diplomuar në një program studimi të të njëjtit cikël studimi që aplikon;
- c) Të jetë kandidat për student nga shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga vendet për të cilat ofrohen bursa sipas pikës 3, të këtij vendimi.

7. Kriteret për përfitimin e bursave, sipas programeve ku do të studiojnë shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës (AKD) dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Për ndjekjen e procesit dhe vlerësimin përfundimtar të dokumenteve të kandidatëve të cilët do të përfitojnë bursë studimi, institucionin e arsimit të lartë dhe programin e studimit ku do të studiojnë krijohet Komisioni i Bursave për Diasporën, me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën. Ai përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët do të propozohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (1 anëtar), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (1 anëtar) dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës (1 anëtar).

8. Agjencia Kombëtare e Diasporës të mbulojë tarifën për ndjekjen e këtij kursi.

9. Financimi i bursave në zbatim të këtij vendimi, për vitin akademik 2021-2022, ka një vlerë prej 71 520 (shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) eurosh. Ky financim do të përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

10. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR DIASPORËN**

PANDELI MAJKO



ANEKSI 1

MASA E BURSËS PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE

Nr.	Studentët me origjinë shqiptare	
	Tarifa e studimit	40000 lekë/vit = 30 Euro/muaj
	Akomodimi	300 Euro/muaj
	Shpenzimet ushqimore	270 Euro/muaj
	Totali mujor i bursës	600 Euro /muaj
	Totali vjetor i bursës	64800 Euro

Nr.	Asistentët për mësimin e gjuhës shqipe	
	Paga mujore	560 Euro/muaj
	Paga vjetore 1 asistent	6720 Euro
	TOTALI (Vlera vjetore totale për studentët dhe asistentët)	71520 Euro